



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në
“Estetikë”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

**KOLEGJI PROFESIONAL “TIRANA ESTHETICS & STYLE
SCHOOL”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Silvana Nini

2. Msc. Ened Kuka

Qershor/2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Tirana Esthetics & Style School ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit me karakter profesional në “Estetikë”. Kolegji Profesional i Lartë TESS ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm, i cili përfundoi me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit si dhe materialet mbështetëse të këtij raporti.

Programi i studimit me karakter profesional në “Estetikë”, është hapur me Urdhër të MASR Nr. 559, datë 12.09.2018. Ky program realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale në “Estetikë”. Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Estetikë-Nutricionit, në Kolegjin Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pas vlerësimit mbi bazë dokumentacioni dhe vizitës në Institucion, hartoi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ).

Ky Raport ka si qëllim vlerësimin e programit të studimit “Estetikë” të Kolegjit Profesional të Lartë TESS, nëpërmjet analizës së organizimit dhe funksionimit të institucionit, duke u bazuar në pesë fushat e vlerësimit dhe standardeve të tyre:

1. Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit me karakter profesional;
2. Struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit me karakter profesional;
3. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat;
4. Burimet për realizimin e programit të studimit dhe mbështetja e studentëve;
5. Studentët dhe mbështetja e tyre.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka përcaktuar edhe shkallën e përmbushjes së çdo standardi të fushave të vlerësimit.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Pas aplikimit për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "Estetikë", të Kolegjit Profesional të Lartë TESS dhe Urdhërit nga ASCAL për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi, u përcaktuan edhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Dr. Silvana Nini;
2. Msc. Ened Kuka.

Fazat e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "Estetikë" janë paraqitur si më poshtë:

1. U ngrit Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe u udhëzua mbi procedurën e vlerësimit për akreditimin e programit, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo anëtari.
2. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri vlerësimin mbi bazë dokumentacioni të paraqitur nga Institucioni aplikues, Kolegji profesional "TESS";
3. Aprovimi i agjendës së vizitës në IAL u bë ndërmjet dy anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe koordinatores teknike të ASCAL;
4. Vizita në institucion u krye në datën 27.05.2020, sipas përcaktimit në agjendë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm realizoi me përpikmëri takimet e caktuara sipas agjendës.

Ditën e mërkurë, më datë 27.05.2020 u realizuan:

- Takimi me Përgjegjësin e Departamentit të Estetikë-Nutricionit;
 - Takimi me Grupin e vetëvlerësimit;
 - Takimi me Stafin akademik (i brendshëm dhe i jashtëm);
 - Takimi dhe intervista me studentët;
 - Takimi me Qendrën e cilësisë/NJSBC dhe me Këshillimin e Karrierës;
 - Takimi me sekretarinë mësimore;
 - Takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore;
 - Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, biblioteka dhe shërbimet për studentët);
 - Takimi përmbyllës.
5. Hartimi i Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe dërgimi i tij në Institucion.

Koordinatorë teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Ersi Dako.

Më datë 19.06.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 3/10 Prot., datë 19.06.2020, përcillet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Më datë 23.06.2020, përmes sistemit AMS, Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e Draft-Raportit. Për sa më lart, Raporti merr formën e tij përfundimtare.



Shënim: Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Estetikë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Estetikë është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Profesional (TESS) që pasqyrohet qartë në strategjinë e zhvillimit të tij.</p> <p>Kjo strategji realizohet duke ofruar program studimi, i cili i pajis studentët me njohuritë e duhura për të qenë profesionistë në fushën e Estetikës.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i IAL dhe ndryshimet në statut; Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të institucionit; Evidenca 1.13 Informacione mbi programin e studimit.</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Programi i studimit me karakter profesional, që ofrohet nga Kolegji është i shprehur në Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit dhe përcakton qartë drejtimin prioritar akademik të këtij programi.</p> <p>Referuar Statutit të Kolegjit, në nenin 3, misioni dhe vizioni i tij është :</p> <ul style="list-style-type: none">- <i>Të realizojë arsimimin profesional, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikës profesionale në fushat që mbulon;</i>- <i>Të kryejë veprimtari praktike në fushën që mbulon dhe ti përdorë ato në favor të veprimtarisë akademike;</i>- <i>Të përgatisë profesionistë me aftësi praktike.</i> <p><i>Vizioni i TESS është që të jenë edukuesit më të admiruar në fushën e kozmetologjisë, estetikës, mirëqënies dhe biznesit të bukurisë duke e ngritur në një nivel të ri standardin e edukimit profesional në Shqipëri.</i></p>
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit, neni 5, ndër objektivat e këtij programi janë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Synimi i këtij programi është të krijojë profesionistë në fushën e estetikës;- Programi është ideuar për t`u dhënë studentëve njohuri në

	<p>fushën e estetikës dhe në të njëjtën kohë i përgatit ata me njohuri të tjera për të bukurën në tërësi.</p> <p>Programi i studimit është përgjegjësi e njërive drejtuese të Kolegjit dhe ofrohet në përputhje me drejtimet akademike të Kolegjit dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit (Departamentit të Estetikë-Nutricionit).</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i IAL dhe ndryshimet ne statut; Evidenca 1.3 Rregullore e institucionit; Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Gjatë vizitës në Kolegjin Profesional TESS vlerësojmë Planin Strategjik të Kolegjit, i cili shpreh faktin se zhvillimet në këtë sektor janë në një trend në rritje.</p> <p>Kolegji TESS ka komunikim zyrtar me punëdhënësit e fushës, mbledh të dhëna mbi nevojat e tregut për profesionistë të diplomuar dhe mundësitë e punësimit real të studentëve pas diplomimit.</p> <p>Hartimi i kurrikulës është bërë duke analizuar nevojat e tregut të punës.</p>			
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi përfshin njohuri bazë formuese dhe praktike në fushën e estetikës.</p> <p>Programi i studimit ka hapësirë të dedikuar praktikës, gjë që i vjen në ndihmë studentëve, jo vetëm për të rritur aftësitë e tyre profesionale por edhe si një mundësi punësimi në institucionet ku realizojnë praktikën.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i IAL dhe ndryshimet ne statut; Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të institucionit; Evidenca 1.3 Rregullore e institucionit.</p>			
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret

Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ thekson se të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat janë të përcaktuara në Statut. Stafi akademik dhe administrativ i Kolegjit janë të mirë organizuar.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Kolegji Profesional TESS ka lidhur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë institucione, biznese dhe aktivitete të tjera mbështetëse. Qëllimi i bashkëpunimit me këto struktura dhe aktivitete ka bërë të mundur që studentët e TESS të kryejnë praktikatat profesionale dhe stazhe pranë këtyre institucioneve. Nëpërmjet marrëdhënies që ka vendosur me këto institucione, Kolegji i krijon mundësi studentëve të marrin njohuri praktike dhe të thellojnë dijet e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Analiza e punës kryhet nga Qendra e Cilësisë, ku realizohen pyetësorë mbi cilësinë e shërbimit të ofruar nga Kolegji.</p> <p>GVJ pa me kujdes edhe raportin analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Këtë fakt na e evidentuan edhe studentët të cilët takoi GVJ gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Ky raport ndihmon studentët e “TESS” në zgjerimin e dijes, bashkëpunimit dhe i parapërgatit për tregun e punës.</p> <p>Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të institucionit; Evidenca 1.4 Rregullore e departamentit; Evidenca 1.7 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera të arsimit të lartë; Evidenca 1.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera mbështetëse; Evidenca 5.8 Raport analitik i përfitimeve nga praktikatat mësimore; Evidenca 5.10 Formularët e mbrojtjes së praktikës mësimore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Kolegji ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Praktikatat mësimore janë të shtrira në kohë gjatë gjithë vitit akademik dhe ndiqen e mbikëqyren nga pedagogët e programit të Estetikës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerri iniciativë specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Këto praktika zhvillohen në ambiente të ndryshme si: qendra e sallone bukurie, qendra estetike, SPA-të, palestrat me SPA, hotele me 5 yje të cilat kanë SPA dhe ofrojnë shërbime estetike.</p> <p>Ka pasur edhe histori suksesi të punësimit të studentëve</p>

	<p>apo të angazhimit të tyre në këto mjedise pune, ku zhvillojnë praktikat mësimore.</p> <p>Evidenca 1.7 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera të arsimit të lartë;</p> <p>Evidenca 1.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera mbështetëse;</p> <p>Evidenca 1.14 Institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale;</p> <p>Evidenca 5.8 Raport analitik i përfitimeve nga praktikat mësimore;</p> <p>Evidenca 5.10 Formularët e mbrojtjes së praktikës mësimore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Estetikë është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimeve të Krediteve (ECTS). Plani mësimor shpreh mënyrën e organizimit të vitit akademik të ndarë në semestra, me lëndët përkatëse dhe të gjithë elementët e tjerë përbërës si kreditet, orët e leksioneve dhe seminareve, orët e studimit etj.</p> <p>Plani mësimor i detajuar është paraqitur më poshtë.</p> <p>Viti i parë / Semestri i parë</p> <p>Lëndët:</p> <ol style="list-style-type: none"> Trajtimet estetike të duarve dhe këmbëve: Kategoria B; 6 kredite; Leksione 60 orë; Seminare 35 orë; Orët e studimit 55. Higjenë, Anatomi dhe Fiziologji: Kategoria B; 8 kredite; Leksione 60 orë; Seminare 30 orë; Orët e studimit 110. Fotografi: Kategoria A; 3 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 50. Historia e bukurisë: Kategoria A; 3 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 50. Etika profesionale dhe komunikimi: Kategoria C; 3 kredite; Leksione 20 orë; Seminare 10 orë; Orët e

studimit 45.

6. **Kimi dhe kozmetologji:** Kategoria C; 4 kredite; Leksione 30 orë; Seminare 20 orë; Orët e studimit 50.
7. **Gjuhë e huaj profesionale Anglisht:** Kategoria D; 3 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 50.

Viti i parë / Semestri i dytë

Lëndët:

1. **Gjuhë e huaj profesionale Italisht:** Kategoria D; 3 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 50.
2. **Teknikat e depilimit:** Kategoria B; 7 kredite; Leksione 60 orë; Seminare 35 orë; Orët e studimit 80.
3. **Bazat e make up:** Kategoria A; 2 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 25.
4. **Menaxhimi i Biznesit:** Kategoria A; 2 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 25.
5. **Terapitë Estetike të Trupit:** Kategoria B; 8 kredite; Leksione 70 orë; Seminare 30 orë; Orët e studimit 100.
6. **Praktika mësimore:** Kategoria D; 4 kredite; 70 orë mësimore; 30 orë studimi.
7. **Detyrime përmbyllëse:** Kategoria E; 2 kredite; 50 orë mësimore.

Viti i dytë / Semestri i parë

Lëndët:

1. **E drejta tregtare:** Kategoria A; 3 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 10 orë; Orët e studimit 50.
2. **Terapitë e fytyrës:** Kategoria B; 7 kredite; Leksione 60 orë; Seminare 35 orë; Orët e studimit 80.
3. **Teknikat e masazhit dhe ritualët terapeutike:** Kategoria B; 8 kredite; Leksione 70 orë; Seminare 30 orë; Orët e studimit 100.
4. **Shitje dhe komunikim:** Kategoria A; 9 kredite; Leksione 80 orë; Seminare 40 orë; Orët e studimit 105.
5. **Bazat e informatikës në biznes:** Kategoria D; 4 kredite; Leksione 15 orë; Seminare 15 orë; Orët e studimit 70.
6. **Dermatologjia:** Kategoria B; 4 kredite; Leksione 70 orë; Seminare 30 orë; Orët e studimit 100.

Viti i dytë / Semestri i dytë

1. **Teknikat e avancuara të make up:** Kategoria C; 5

	<p>kredite; Leksione 30 orë; Seminare 20 orë; Orët e studimit 75.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Nutricion dhe dietologji: Kategoria C; 4 kredite; Leksione 30 orë; Seminare 20 orë; Orët e studimit 50. 3. Trajtimet estetike të fytyrës: Kategoria B; 8 kredite; Leksione 70 orë; Seminare 30 orë; Orët e studimit 100. 4. Praktika mësimore: Kategoria D; 4 kredite; 50 orë mësimore; Orët e studimit 50. 5. Detyrime përmbyllëse: Kategoria E; 2 kredite; 50 orë mësimore. <p>Pas përfundimit të studimeve studentët pajisen me diplomën përkatëse, transkriptin e notave si dhe me suplementin e diplomës, e cila jep informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit.</p> <p>Programi Estetikë është në përputhje me nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (e cila ka 8 nivele) (aprovuar me Ligjin Nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”) CShAL – Cikli i shkurtër i Arsimit të Lartë (anglisht: SCHE Short cycle of Higher education).</p> <p>Evidenca 1.9 Programi i studimit Estetikë. Evidenca 1.10 Plani mësimor. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Estetikë” plotëson nevojat e studentëve që të përfitojnë të gjitha njohuritë e nevojshme të specializuara teorike dhe praktike.</p> <p>Programi i studimit “Estetikë”, nëpërmjet Lëndëve Bazë, Lëndëve Karakterizuese, Lëndëve Ndërdisciplinore / integruese, Lëndëve Plotësuese, Praktikës Profesionale dhe Detyrimeve Përmbyllëse, synon pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit “Estetikë”, nëpërmjet Lëndëve Bazë, Lëndëve Karakterizuese, Lëndëve Ndërdisciplinore / integruese, Lëndëve Plotësuese, Praktikës Profesionale dhe Detyrimeve Përmbyllëse, synon pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Synimi parësor i këtij programi është të krijojë profesionistë në fushën e estetikës. Programi Estetikë ofron lëndë të formimit të përgjithshëm si Etika Profesionale dhe Komunikimi, E Drejta Tregtare dhe Menaxhimi i Biznesit që i vijnë në ndihmë studentëve në mënyrë që të mësojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre për të menaxhuar veprimtaritë dhe aktivitetin e tyre profesional.</p>

	<p>Evidenca 1.9 Programi i studimit Hair Artist; Evidenca 1.10 Plani mësimor; Evidenca 1.11 Kuadri i përgjithshëm formues; Evidenca 1.14 Institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Kolegji Profesional i Lartë TESS, ka hartuar programin e Estetikës në bazë të kërkesave ligjore dhe përmbush standardet e cilësisë së organizimit, strukturës akademike dhe kualifikimit të stafit akademik.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, në departamentin përgjegjës për këtë program studimi, janë të punësuar 9 personel akademik, prej të cilëve 6 me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin 2 Dr. dhe 4 Msc. dhe 3 me kontratë (PAK), me kualifikimin 1 Prof. As. dhe 2 Msc. Personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kontratë i përket fushave të Hair Artist, Artit pamor (pikturë, art skenik, histori e artit, fotografi dhe Make Up Artist); Farmaceutikë-kozmetologji; Administrim dhe marketing; Kimi.</p> <p>Në programin e studimit janë të angazhuar në mësimdhënie i gjithë personeli akademik i të dy departamenteve, në total 17 pedagogë, si vijon: - 12 PAE, me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 3 Dr., dhe 8 Msc.; - 5 PAK, me kualifikimin: 2 Prof. As., 1 Dr., dhe 2 Msc.</p> <p>Evidenca 1.6 Lista e personelit akademik të programit të studimit; Evidenca 1.10 Plani mësimor; Evidenca 1.12 Lista e personelit akademik të Kolegjit; Evidenca 3.8 CV e stafit akademik të programit të studimit. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit Estetikë ka të përcaktuar objektivat që lidhen me formimin profesional të studentëve, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata përfitojnë në përfundim të studimeve dhe çdo karakteristikë tjetër që lidhet me profilin profesional të programit.</p> <p>Referuar Evidencës 1.9, programi i studimit Estetikë, është ideuar për tu dhënë studentëve përfitimin e njohurive bazë të anatomisë dhe fiziologjisë normale të sistemit tegumentar.</p> <p>Evidenca 1.9 Programi i Studimit Estetikë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Programi i studimit Estetikë në Kolegjin TESS përmban dhe jep informacionin e nevojshëm që nga objektivat formues të programit, rezultatet e të nxënit, organizimin, strukturën deri në mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Programi i studimit për Estetikë jep informacion mbi mënyrat e vlerësimit të studentit, rregullat dhe procedurat e diplomimit, si dhe format e mësimdhënies të përshkruara në syllabuset lëndore që e shoqërojnë.</p> <p>Një program studimi përcakton në veçanti:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. listën e disiplinave mësimore, të ndara në module si dhe veprimtari të tjera formuese; 2. objektivat formues specifikë të çdo disipline apo veprimtarie tjetër formuese; 3. kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë mësimore apo veprimtari tjetër formuese; 4. kurrikula, që u ofrohen studentëve; 5. format e studimit, të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët; 6. detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin; 7. kushtet për procedurat dhe modalitetet për transferimin e studentëve. <p>Evidenca 1.9 Programi i studim Estetikë; Evidenca 1.10 Plani mësimor. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të</p>	<p>Programi i studimit Estetikë është i organizuar në</p>




organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.

lëndë/module dhe aktivitete formuese të cilat janë të ndara në kredite sipas semestrave përkatës.

Programi Estetikë ka kohëzgjatjen e 2 (dy) viteve akademike dhe është i ndarë në katër semestra. I gjithë organizimi i programit të studimit dhe planit mësimor është bërë sipas legjislacionit në fuqi e përcaktimeve vendase e evropiane.

Në planin mësimor është synuar të ruhet një raport i drejtë midis formimit të përgjithshëm, formimit bazë dhe atij profesional të studentëve për të gjitha nivelet.

Veprimtaritë formuese të çdo programi dhe përshtatja e raportit të tyre bëhet sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Planet mësimore të secilit cikël organizohen mbështetur në Deklaratën e Bolonjës, ku thelbësor mbetet “Sistemi evropian i transferimit të krediteve”, ECTS (European Credit Transfer System), i cili bën të mundur matjen e të mësuarit dhe arritjet e tij, si dhe ka në qendër ngarkesën e punës që studenti duhet të kryejë për të arritur objektivat e programit të tij të studimit.

Programi përbëhet nga 25 lëndë (përfshirë këtu praktikat profesionale si dhe projektet finale) në 2 (dy) vite.

Lëndët kanë nga 2 (dy) deri 9 (nëntë) kredite, në varësi të ngarkesës dhe rëndësisë së tyre.

Lëndët ndahen në disa kategori, sipas veprimtarisë që ato mbulojnë dhe njohurive që duan të transmetojnë.

Lëndët e kategorisë së disiplinave të përgjithshme (A) kanë 22 kredite dhe këtu bëjnë pjesë lëndë si: E drejta Tregtare, Fotografi, Historia e Bukurisë, Menaxhimi i Biznesit, Shitje dhe Komunikim.

Grupi më i rëndësishëm i lëndëve është ai i disiplinave karakterizuese (B), të cilat kanë 60 kredite dhe janë kryesisht këto kurse që formojnë profesionistin në estetikë.

Lëndët e kategorisë ndërdisiplinore / integruese (C) kanë 16 kredite dhe këtu përfshihen lëndë si Etika profesionale dhe komunikimi, Kimi dhe kozmetologji, etj.

Rëndësi e veçantë është treguar edhe ndaj lëndëve plotësuese të kategorisë (D), ku përfshihet edhe praktika

	<p>profesionale, kategori e cila ka 10 kredite.</p> <p>Gjithashtu është edhe kategoria E, Detyrimet përmbyllëse (Projekti Final), e cila ka 4 kredite.</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor; Evidenca 2.1 Elementet e programit të studimit; Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Plani mësimor është dokumenti kryesor i cili shpreh organizimin e vitit akademik për programin e studimit Estetikë.</p> <p>Ky plan është i ndarë në katër semestra dhe ka të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me lëndët për cdo semestër, pedagogun përgjegjës për këtë lëndë, ngarkesën mësimore, orët në auditor, ndarjen e orëve të leksionit dhe semestrave, kreditet e gjithashtu orët e studimit.</p> <p>Ngarkesa mësimore ndahet sipas titujve shkencorë, pedagogu me Titull Shkencor Prof. dhe Prof.As normën vjetore e ka 140 orë; pedagogu me gradën shkencore Doktor dhe Docent normën vjetore e ka 165 orë dhe As. Lektor normën vjetore e ka 195 orë.</p> <p>Ngarkesa mësimore ndahet nga dy departamentet e Kolegjit Profesional TESS, Departamenti Estetikës dhe Nutricionit (ku ngarkesa e stafit të brendshëm është 1350 orë dhe ngarkesa e stafit të jashtëm 150 orë) dhe Departamenti i Kozmetologjisë (ku ngarkesa e stafit të brendshëm është 1990 orë dhe ngarkesa e stafit të jashtëm 260 orë).</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor. Evidenca 4.2 Ngarkesa e detajuar 2019-2020. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Çdo lëndë e programit të studimit Estetikë ka syllabusin e detajuar i cili ju informohet studentëve me nisjen e vitit akademik, sipas Udhëzimeve të MASR.</p> <p>Syllabuset për çdo lëndë, pasqyrojnë këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimi i lëndës/modulit; - Viti/semestri kur zhvillohet lënda; - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës;

	<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; - Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik; - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; - Format e vlerësimit të studentëve; - Detyrimet e studentit për lëndën; - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse. <p>Përputhja e lëndës së pedagogut me formimin e tij akademik është një vlerë e shtuar në programin e studimit Estetikë. Për secilën lëndë ka syllabusin e detajuar sipas përcaktimit të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018.</p> <p>Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Hair Artist.</p>			
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit, gjatë vitit akademik është fleksibël, gjë që mundëson studentët të jenë të aftë të punojnë në disa disiplina më bazike.</p> <p>Mësimi praktik dhe puna konkrete ka peshën dhe vendin e duhur në strukturën e programit. Vlerësimi i punës konkrete të studentët është e rëndësishme në vlerësimin përfundimtar që ato marrin.</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor; Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Estetike Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>			
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.2</p> <p>Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxëniet sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në</p>	<p>Elementë si emërtimi, struktura dhe shpërndarja në semestra e vitit akademik, vlerësimi në kredite dhe orë</p>

<p>përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>mësimore në Kolegjin TESS për programin Estetikë është bërë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me 120 kredite, në 2 vite akademike, 4 (katër) semestra. Veprimtaria akademike e këtij programi ka filluar në vitin akademik 2018-2019.</p> <p>Këto elementë bëjnë të mundur arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, e gjithashtu të rezultateve të pritshme të të nxënit e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Plani mësimor, emërtimi i lëndëve/moduleve, syllabuseve të tyre dhe veprimtarive formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e duhura. Raporti i formimit teorik/praktik ka një raport të duhur në mënyrë që studentët të marrin të gjitha njohuritë teorike të ndërthurura me ato praktike. Përmendim këtu grup lëndët e programit Estetikë të cilat konsiderohen si shtyllat e formimit profesional të këtij programi:</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Estetikë dhe Dermatologji; 2. Make Up; 3. Art dhe fotografi; 4. Biznes dhe Ligj; 5. Gjuhë të huaja profesionale.
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Vlerësojmë klasifikimin e lëndëve sipas fushave disiplinore apo veprimtarive formuese me karakter teorik dhe praktik të tilla si:</p> <p>Kategoria A</p> <p>Lëndë bazë – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (1. Fotografi; 2. Historia e bukurisë; 3. Bazat e make up; 4. Menaxhim biznesi; 5. E drejta tregtare; 6. Shitje dhe komunikim).</p> <p>Kategoria B</p> <p>Lëndë karakterizuese – Përgatitje për programin e studimit (1. Trajtimet Estetike të Duarve dhe Këmbëve; 2. Higjenë, anatomi dhe fiziologji; 3. Teknikat e Depilimit; 4. Terapitë Estetike të Trupit; 5. Terapitë e Fytyrës; 6. Teknikat e Masazhit dhe Rituale Terapeutike; 7. Dermatologji; 8.</p>

Trajtimet Estetike të Fytyrës).

Kategoria C

Lëndë ndërdisiplinore / integruese – Nëndisiplina profile dhe grup lëndësh me zgjedhje (1. Etika profesionale dhe komunikimi; 2. Kimi dhe kozmetologji; 3. Teknikat e Avancuara të Make up; 4. Nutricion dhe Dietologji).

Kategoria D

Lëndë plotësuese – Gjuhë të huaja dhe praktika profesionale (1. Gjuhë e huaj profesionale Anglisht; 2. Gjuhë e huaj profesionale Italisht; 3. Praktika mësimore; 4. Bazat e Informatikës në Biznes; 5. Praktika mësimore)

Kategoria E - Detyrime përmbyllëse, Diploma.

Raporti midis lëndëve të formimit teorik dhe atyre të formimit praktik është i balancuar në raportin 50:50.

Lëndë të formimit praktik:

1. Trajtimet Estetike të Duarve dhe Këmbëve;
2. Terapitë Estetike të Trupit;
3. Teknikat e Depilimit;
4. Bazat e Make Up;
5. Terapitë e Fytyrës;
6. Teknikat e Mesazhit dhe Ritualet Terapeutike;
7. Teknikat e Avancuara të Make Up
8. Trajtimet Estetike të Fytyrës;
9. Fotografi;
10. Praktika mësimore;
11. Diploma.

Lëndë të formimit teorik

1. Higjenë, anatomi dhe fiziologji;
2. E drejta tregtare;
3. Historia e bukurisë;
4. Dermatologji;
5. Menaxhim biznesi;
6. Shitje dhe komunikim;
7. Etika profesionale dhe komunikimi;
8. Kimi dhe kozmetologji;

	<p>9. Nutricion dhe dietologji;</p> <p>10. Gjuhë e huaj profesionale Italisht;</p> <p>11. Gjuhë e huaj profesionale Anglisht.</p> <p>12. Bazat e Informatikës në Biznes.</p> <p>Një pjesë e rëndësishme e programit Estetikë në masën më tepër se 25 % i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion.</p> <p>Veçojmë këtu, nga 23 lëndët e programit të Estetikës, lëndët që i dedikohen drejtpërdrejtë aftësisimit në punë konkrete në profesion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajtimet Estetike të Duarve dhe Këmbëve; 2. Terapitë Estetike të Trupit; 3. Teknikat e Depilimit; 4. Terapitë e Fytyrës; 5. Teknikat e Mesazhit dhe Ritualet Terapeutike; 6. Trajtimet Estetike të Fytyrës. <p>Rëndësia që ka për këtë program përfshirja e elementeve teorike krahas atyre praktikë, bën të mundur që studentët, pasi të përfundojnë studimet, të jenë jo vetëm profesionistë të mirë, por të kenë zhvilluar edhe aftësitë komunikative, sipërmarrëse dhe organizative.</p> <p>Evidenca 1.9 Programi i studimit Estetik;</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor;</p> <p>Evidenca 2. 1 Elementet e programit të studimit;</p> <p>Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit për Estetikë përmban të dhëna të plota lidhur me përmbajtjen e të gjitha lëndëve (teorike dhe praktike), çdo njohuri që merret në secilën prej tyre dhe aktiviteteve të tjera të formimit.</p>

<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Struktura e planit të studimit është e shprehur në programin e studimit dhe përmbajtja e këtij programi është aktuale, në përshatje me kërkesat e tregut dhe aftësitë e shprehite e kërkuara e të pritshme nga punëdhënësi.</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit për Estetikë ka si qëllim zhvillimin e aftësive të transferueshme në nivel të lartë dhe profesional, që pasqyrohet kryesisht në përmbajtjen e lëndëve, planin mësimor dhe metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p> <p>Referuar Rregullores së programit të studimit, neni 12, Kolegji pranon transferime nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Njëkohësisht ky Kolegj lejon edhe transferimin e studentëve të tij në programe të ngjashme me karakter profesional.</p> <p>Studentët e këtij Kolegji kanë të drejtë të kërkojnë transferimin e krediteve të marra për lëndë të njëjta ose të ngjashme të cilat i kanë marrë në institucione të tjera për programe të caktuara studimi.</p> <p>Njohja e lëndëve dhe vlerësimi i krediteve, bëhet nga një Komision i veçantë i ngritur për këtë qëllim.</p> <p>Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit. Evidenca 1.10 Plani mësimor; Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve të programit Hair Artist. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Lëndët e formimit teorik janë hartuar në mënyrë të tillë që studentët të kenë mundësinë të përfitojnë njohuritë e duhura, mendimin kritik dhe aftësitë praktike.</p> <p>Përfshirja në Program e disa Lëndëve Specifike si Etika Profesionale dhe Komunikimi, Menaxhimi i Biznesit, Komunikimi dhe Shitja shërbejnë si një ndër elementët më të rëndësishëm, të cilat para përgatisin studentët të jenë gati për tregun e punës dhe të kenë aftësinë për t'u përballur me situata të ndryshme.</p> <p>Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve të programit Estetikë.</p>
<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Praktika mësimore që zhvillohet gjatë programit mësimor është një ndër pikat e forta të programit Estetikë, dhe që duhet vlerësuar.</p> <p>Si njohuritë, e marra gjatë vitit akademik edhe përfshirja e studentëve në aktivitete me subjekte të ndryshme, i</p>

	<p>ndihmon ata të përballen me tregun e punës gjatë periudhës së studimeve.</p> <p>Ky proces favorizon punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor; Evidenca 1.14 Institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura e posaçme që zhvillon mekanizmat e vlerësimit dhe të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies në Kolegjin Profesional TESS. Kjo strukturë, monitoron dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies periodikisht përmes pyetësorëve të studentëve dhe të stafit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ, takoi Njësinë e sigurimit të cilësisë. Anëtarët e kësaj njësie bënë një pasqyrim të plotë të punës së tyre gjatë vitit akademik 2018-2019, duke qënë të vetëdijshëm që si strukturë e re, puna e tyre në vijimësi do të vijë në rritje.</p> <p>Pyetësorët përmbajnë pyetje të cilat janë direkte dhe të ndara sipas lëndëve në mënyrë që informacioni që merret prej tyre të jetë i qartë e të ketë mundësi për të bërë përmirësime.</p> <p>Pas shpërndarjes së të dhënave dhe mbledhjes së pyetësorëve hartohet një raport nga Njësia e Sigurimit të</p>

	<p>Brendshëm të Cilësisë, rezultatet e të cilit i bëhen me dije strukturave përkatëse.</p> <p>Evidenca 3.1 Rregullore e NJSBC; Evidenca 3.2 Raporti i NJSBC; Evidenca 3.3 Pyetësori i studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Natyra e programit të studimit Estetikë është shumë specifike, për këtë arsye lëndët që zhvillohen janë të përshtatura me këtë lloj profesioni. Format e mësimdhënies, mësimnxënies, në këtë program studimi janë: leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Stafi akademik është angazhuar në hartimin e programeve të lëndëve të përshtatshme për këtë program studimi duke pasur parasysh elementët specifikë të fushës. Kolegji Profesional i Lartë TESS ka hartuar programin e Estetikës sipas të gjitha standarteve dhe kërkesave ligjore. Aktualisht në këtë department janë të punësuar 5 pedagogë me kohë të plotë.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies në lidhje edhe me profilin që mbulojnë:</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lektorët përgjegjës për lëndët e formimit profesional të këtij programi studimi: Njëra nga lektorët ka mbaruar Universitetin e Arteve në Tiranë në degën e artit skenik dhe ka bërë trajnime të avancuara në fushën e kozmetologjisë (Hair dhe Make Up Artist). Gjithashtu lektorja ndihmëse ka mbaruar Universitetin e Arteve në Tiranë për pikturë dhe ka eksperiencë në fotografi dhe grafik dizajn, eksperiencë kjo mjaft e dobishme për këtë program studimi. 2. Lektorja e lëndëve “Bazat e Make Up” dhe “Teknikat e avancuara të Make up”, përveç diplomës “Multimedia dizajner” në Universitetin e Arteve në Tiranë, ka bërë trajnime të avancuara në Akademinë Italiane “Make Up Forever”. Shtojmë këtu edhe eksperiencën e punës në këtë fushë. 3. Lektorët përgjegjës për lëndën “Kimi dhe kozmetologji” janë të diplomuar respektivisht: Njëri prej lektorëve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dega Kimi dhe Teknologji Ushqimore dhe në Fakultetin e Mjeksisë, dega

	<p>Farmacit. Lektorit tjetër në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dega Kimi Industriale dhe njëkohësisht ka edhe postin e Shefit të Departamentit të Kozmetologjisë dhe ka gradën shkencore Dr. i Shkencave.</p> <p>4. Lektorja e lëndëve “Gjuhë e huaj profesionale Anglisht” dhe “Gjuhë e huaj profesionle Italisht” është e diplomuar në gjuhën Angleze dhe çertifikatën e gjuhës italiane. Gjithashtu ka eksperiencë në punë si mësuese e gjuhës angleze dhe një sërë trajnimesh e kualifikimesh.</p> <p>5. Lektorja e lëndëve “Etika profesionale dhe komunikimi” dhe “Menaxhimi i biznesit” është e diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në degën Administrim Biznesi dhe ka Master Shkencor në Marketing. Gjithashtu mban edhe rolin e Koordinatorës pranë Kolegjit TESS.</p> <p>6. Lektorit i lëndës “Fotografi”, është personel i jashtëm, është i diplomuar në Akademinë e Arteve. Ka një diplomë nga Muzeu i Artit Modern në New York mbi fotografinë. Mban titullin shkencor Prof. As., dhe ka një eksperiencë pune të gjatë dhe të sukseshme në fushën e fotografisë artistike.</p> <p>7. Lektorit i lëndëve “Teoria e ngjyrës” dhe “Historia e bukurisë” është i diplomuar në Akademinë e Arteve në Tiranë për pikturë dhe në Universitetin e Bolonjës për Historinë e Artit Kontemporan. Gjithashtu mban titullin shkencor Dr. i Shkencave. Ka një eksperiencë pune si kurator dhe ka bërë një sërë botimesh me karakter shkenor mbi Historinë e Artit Shqiptar.</p> <p>Kolegji mbështet stafin për realizimin me sukses të orëve mësimore dhe përdorimit të metodave interaktive nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve dhe materialeve të nevojshme.</p> <p>Gjithashtu Kolegji nxit dhe inkurajon shkëmbimin e eksperiencave më të mira midis vetë stafit akademik, si pjesë e punës për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 3.4 Udhëzues për metodat e inovative të mësimdhënies; Evidenca 3.5 Aktivitete të organizuara nga Kolegji; Evidenca 3.8 CV e stafit akademik të programit të studimit; Evidenca 4.7 Kontratat e punës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.2	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Në vizitën e zhvilluar në ambjentet e Kolegjit Profesional TESS, konfirmojmë se veprimtaria akademike ushtrohet në një mjedis me hapësira të mjaftueshme, cilësore dhe funksionale ku përfshihet logjistika e nevojshme për realizimin cilësor të procesit mësimor.</p> <p>Përmendim këtu: pajisjet e duhura cilësore të arredimit të klasave; pajisjet me teknologjinë e fundit ku përfshihen (sistemi audio, videoprojektor dhe mikrofona të cilët përdoren nga lektorët, kompjuter dhe laptopë që u vihen në dispozicion studentëve).</p> <p>Çdo sallë ka ajër të kondicionuar dhe sistem qëndror ngrohje-ftohje dhe është e izoluar nga lagështira, gjithashtu Kolegji zotëron lejen Higjeno Sanitare nga institucioni përkatës.</p> <p>Hapësira dhe infrastruktura e Kolegjit janë të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi. Sallat janë funksionale e të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin me cilësi të programit mësimor.</p> <p>Pajisjet që janë vënë në dispozicion janë të një standardi të lartë, në mënyrë që studentët të jenë të aftë të punojnë në kushtet ideale të punës, duke qenë se profesioni i Estetikës është specifik.</p> <p>Evidenca 3.6 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit; Evidenca 3.13 Raport i ekspertit për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ pa me kujdes gjatë vizitës në Institucion ambientet në funksion të këtij programi mësimor. Këto ambiente janë të pajisura me mjetet e nevojshme për realizimin e planit mësimor.</p> <p>Produktet e fushave specifike me të cilat punojnë studentët janë ndër më të vlerësuarat e fushës në tregun ndërkombëtar të estetikës. Infrastruktura e përshtatshme dhe kushtet komode që ofron ky Kolegj, ishin refren edhe i</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe</p>	

elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	takimit që pati GVJ me studentët.			
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Kolegji disponon pajisjet e nevojshme higjienizuese si Autoklava, të cilat shërbejnë për sterilizimin e përditshëm të pajisjeve dhe mjeteve me të cilat punojnë studentët duke siguruar standartet maksimale të higjenës, të cilat parandalojnë transmetimin e sëmundjeve infektive.			
Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Investimi në laboratorët ku ndodhet çdo pajisje e mjet i nevojshëm për zhvillimin e praktikave mësimore, ka krijuar mundësinë që në këto salla të realizohen trajnime ose workshope të ndryshme, pa penguar procesin akademik të TESS.			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Literatura e nevojshme vihet në dispozicion të studentëve në çdo kohë, në variantin e printuar ose elektronik, sipas kërkesës së studentëve dhe njëkohësisht ajo gjendet në bibliotekën e Kolegjit.			
	Vlen të vlerësojmë këtu punën e bërë nga disa lektorë me realizimin e literaturës në gjuhën shqipe ne formën e librit për lëndët e formimit profesional (Kjo literaturë profesionale ishte bërë gati për shtyp).			
	Kolegji TESS ka përgjegjës për Arkivën, e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumentacionit në letër, sipas legjislacionit në fuqi.			
	Evidenca 3.3 Pyetësori i studentëve; Evidenca 3.6 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit; Evidenca 3.7 Rregullore e arkivës; Evidenca 3.13 Raport i ekspertit për infrastrukturën.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë	Programet e studimit të Kolegjit dhe planet mësimore të tyre janë të organizuara sipas udhëzimeve të MASR me të gjithë elementët përbërës. Monitorimi i zbatimit të syllabuseve dhe planit mësimor, bëhet periodikisht nga

<p>kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Anëtarë të saj janë persona që kanë tashmë një përvojë të mirë për të monitoruar e kontrolluar mbarëvajtjen akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Anëtarët e NJBSC kanë qënë pjesë e procesit të vlerësimit në pozita të ndryshme si ish drejtues, lektorë apo dhe studentë, gjë që ju ka vlejtur për të kuptuar nga afër procesin.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Kolegji garanton kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit teorik dhe praktik të studentëve. Mbikëqyrja e praktikave mësimore, ndjekja e projekteve, temave të diplomave etj, realizohet sipas ndarjes së pedagogëve në vendimet e departamentit.</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik i Kolegjit janë përgjegjës për zbatimin me rigorozitet të programit të studimit dhe nxiten nga Kolegji të përdorin metoda të reja mësimdhënie të cilat janë në përputhje me natyrën e programit të Estetikës.</p> <p>Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë: nga studentët, kolegët, vetëvlerësimi dhe nga eprori/ët.</p> <p>Stafi akademik është i përbërë nga profesorë, doktorë, si dhe kërkues të rinj të nivelit post-master. Kjo larmishmëri krijon një proces mjaft të mirë në mësimdhënie. Studentët ishin mjaft të kënaqur nga pedagogët e tyre.</p> <p>Evidenca 3.1 Rregullore e NJSBC; Evidenca 3.8 CV e stafit akademik të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.</p>	<p>Përgjegjësia për cilësinë e mësimdhënies i takon Kolegjit Profesional TESS. Ky proces kontrollohet periodikisht nga strukturat e brendshme të departamenteve, si edhe nga strukturat e institucionit.</p> <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë garanton cilësinë e aktiviteteve akademike dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke informuar nivelin drejtues të Kolegjit për situatën aktuale dhe problematikat. Ky informacion i shërben drejtuesve të Kolegjit për të siguruar rritjen e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Ky monitorim realizohet përmes pyetësorëve që u drejtohen studentëve dhe raporti iu bëhet me dije edhe stafit akademik e drejtuesve të Kolegjit.</p>

	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik, testojnë metoda të cilat stimulojnë pjesëmarrjen e studentëve si dhe ndërveprimin në klasë. Ky fakt ju pohua edhe GVJ në takimin me përgjegjës të departamentit por edhe me stafin akademik të programit.</p> <p>Evidenca 3.4 Udhëzues për metodat inovative të mësimdhënies; Evidenca 3.9 Procedura e hartimit dhe miratimit të programit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	<p>Programet janë të organizuara në module. Çdo modul përmban tema të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe zakonisht zgjasin një semestër. Pas shlyerjes së provimit ose provimeve të lëndës, jepet vlerësimi përkatës.</p> <p>Rregullorja e Provimeve është dokumenti zyrtar i cili shpreh të gjitha procedurat e vlerësimit të njohurive dhe të dijeve.</p>
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale përftohet nga mbledhja e pikëve të ndara përgjatë semestrit dhe pikëve të provimit final. Vlerësimi realizohet nga disa komponentë si Aktivizimi, Prezenca, Provimet e Ndërmjetme dhe Provimi Final brenda një moduli, duke u dhënë kështu mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.</p>
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	<p>Institucioni ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p> <p>Në çdo lëndë, studenti informohet për mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe të aftësive praktike. Ky informacion është i pasqyruar edhe në syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Kreditet e përcaktuara për çdo lëndë janë një tregues sasior, i cili lidhet me ngarkesën e kohës së studimit. Sipas planit, kreditet në vit/semestër ndahen në këtë mënyrë: në</p>

	<p>vitin e parë, semestrin e (parë) janë 30 ECTS, në semestrin e dytë janë 28 ECTS; ndërsa në vitin e dytë, semestrin e parë janë 39 ECTS dhe në semestrin e dytë janë 23 ECTS. Studenti mbledh kredite vetëm kur ka shlyer me sukses çdo detyrim të lëndës, si për shembull detyra kursi, provimin ose provimet.</p> <p>Studenti gëzon të drejtën të shkruajë provimin përfundimtar vetëm nëse ka frekuentuar të paktën 75 % të orëve mësimore të modulit përkatës. Nëse ky kusht i domosdoshëm nuk përmbushet, studentit i jepet sërish e drejta të regjistrohet në sezonin e vjeshtës për të shlyer detyrimet e lëndës.</p> <p>Vlerësimi final ndërtohet gjatë gjithë semestrit/vitit dhe është rezultat i ponderuar i disa elementëve, pesha e të cilëve varion në përputhje me natyrën e lëndës.</p> <p>Pesha e secilit komponent vlerësimi jepet në programet e secilës lëndë dhe ato ndryshojnë ndjeshëm nga njëra-tjetra.</p> <p>Ndjekja e lëndës (prezenca) është e fiksuar në 10 %, ndërkohë që aktivizimi gjatë orëve të diskutimeve varion sipas lëndës dhe mund të shkojë deri në 40 %. Po kështu, detyrat e kursit, projektet apo punët laboratorike, variojnë deri në 90 %, sipas specifikave të kursit, dhe më pas zhvillohet provimi final.</p> <p>Evidenca 3.10 Rregullorja e provimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Rregullorja e zhvillimit të provimeve garanton procedurat e kryerjes së provimit, anonimitetin gjatë korrigjimit përmes kodit individual të sekretimit, anonimitetin e shpalljes së rezultateve dhe procedurën e ankimimit të parashikuar në rregulloren e rishikimit dhe apelimit të rezultatit të provimit, edhe pse Kolegji nuk ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Forma e testimit të aplikuar janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Me shkrim; Me gojë; Detyrat e kursit.
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit shpallen para plotësimit të dokumentacionit përkatës.</p> <p>Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë sipas udhëzimeve të Rregullores për Rishikimin dhe apelimin e Rezultatit të</p>

<p>rregullore.</p>	<p>provimeve.</p> <p>Pas çdo provimi, studentit i jepet mundësia, që me anë të një kërkese me shkrim, të rishikojë tezën e tij. Pedagogu i lëndës, për çdo rishikim përcakton ditën dhe orën dhe sqaron studentin në lidhje me vlerësimin e bërë.</p> <p>Në rastet e kontestimit të rezultatit, ngrihet një komision në të cilin duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i departamentit, për të monitoruar transparencën e procesit.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë.</p> <p>Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit.</p> <p>Evidenca 3.10 Rregullorja e provimeve; Evidenca 3.11 Rishikimi dhe apelimi i rezultatit të provimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School” vepron në fushën e arsimit të orientuar profesional.</p> <p>Programi i studimit “Estetikë” garanton formimin e përgjithshëm teorik dhe praktik, gjë që garanton përfitim e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Po ashtu garanton edhe zhvillimin e aftësive të veçanta si ato të komunikimit dhe ndërveprimit, mbështetjen dhe pjesëmarrjen në punën me grupe dhe zgjidhjen e problematikave të veçanta.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Ky program studimi ka si misionin të tij:</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e</p>	<p>a) Arsimimin profesional, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikës profesionale në fushat që mbulon;</p> <p>b) Të kryejë veprimtari praktike në fushat që mbulon dhe t’i përdorë ato në favor të veprimtarisë akademike;</p>

<p>biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>c) Të përgatisë profesionistë me aftësi praktike.</p> <p>Kolegji i kushton rëndësi cilësisë së procesit mësimor, procedurave që lehtësojnë kualifikimin e stafit akademik, duke rritur cilësinë dhe standartet e proceseve akademike.</p>			
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Procesi i mësimor kontrollohet periodikisht nga strukturat e brendshme të departamenteve, si edhe nga strukturat e institucionit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë garanton cilësinë e aktiviteteve akademike.</p> <p>Stafi akademik është i përfshirë në përmirësimin e programeve të studimit dhe të mësimdhënies të cilat diskutohen në mbledhjet e departamentit.</p> <p>Evidenca 3.9 Procedurat e hartimit dhe miratimit të programit të studimit; Evidenca 3.14 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Kolegji TESS ka hartuar procedurën e mbrojtjes së diplomës dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit dhe mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar. Sipas kësaj procedure studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPL “Tirana Esthetics & Style School”, fiton të drejtën e marrjes së diplomës.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Departamenti, personeli akademik dhe udhëheqësit orientojnë dhe ndihmojnë studentët që nga përzgjedhja e temës, përgatitja e punimit të diplomës, e deri te mbrojtja e saj.</p> <p>Forma e diplomës, elementët e sigurisë, si edhe elementë të tjerë të saj përcaktohen me dokument të veçantë. Diploma nuk mund të lëshohet duplikatë, ajo jepet vetëm një herë. Diploma regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni.</p> <p>Në fushën e Estetikës, në Kolegjin TESS, garantohet bashkëpunimi me aktorë të jashtëm, me mjekë dermatologë, farmacistë, etj.</p> <p>Evidenca 3.12 Rregullore e diplomimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School (TESS) zbaton procedura dhe harton kriteret për përzgjedhjen e stafit (akademik dhe jo akademik) në përputhje me përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p> <p>Institucioni i përmbahet kërkesave ligjore të Arsimit të Lartë si dhe procedurave të vendosura që pedagogët të kenë njohuri dhe kompetenca të plota të lëndës që mbulojnë.</p> <p>Procedura e rekrutimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti paraqet kërkesën për plotësimin vakant të punës duke specifikuar kriteret që duhet të plotësojë kandidati. 2. Kërkesa i përcillet rektorit të Kolegjit. 3. Rektori shpall konkursin për këtë vend vakant pune. <p>Kriteret e përcaktuara nga Kolegji TESS:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diplomë e studimeve universitare në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. • Tituj dhe grada shkencore (Dr., Prof. As., Prof.) • Preferohen me PHD të fituar jashtë vendit. <ol style="list-style-type: none"> 4. Përzgjedhja e pedagogëve bëhet nga një komision i rekrutimit të stafit akademik mbështetur në: <ol style="list-style-type: none"> a) Dosjen e dorëzuar b) Intervistën 5. Rektori bën miratimin përfundimtar të kandidatit fitues




	<p>për personel akademik ose administrativ dhe vendos datën e fillimit të marrëdhënieve financiare dhe pagën mujore.</p> <p>6. Lidhet një kontratë pune me personelin akademik.</p> <p>Evidenca 1.6 Lista e personelit akademik për programin Estetikë; Evidenca 4.1 Politikat dhe procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore; Evidenca 4.7 Kontratat e punës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Të dhënat për personelin ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik, të cilat përfshijnë anëtarët e personelit akademik, (si të brendshëm ashtu edhe të ftuar) dhe shefin e departamentit.</p> <p>Në këto të dhëna përfshihet CV e përditësuar, kualifikimet apo të dhëna mbi punimet e tyre shkencore ose jo shkencore dhe kontrata e punës. Institucioni përditëson edhe të dhënat për stafin ndihmës mësimor dhe atë administrativ ku përfshihet CV, veprimtaritë e tyre dhe kontrata e punës. Gjithshtu institucioni përditëson edhe angazhimin e personelit si të atij akademik dhe ndihmës akademik (të përditësuar në ndarjen e orëve mësimore të lëndëve në këtë program studimi) ashtu edhe angazhimin e personelit administrativ që pasqyrohet në kontratën e tyre të punës.</p> <p>Në zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden dosjet e personelit akademik, dosje e personelit administrativ dhe kontratat e punës si për personelin e brendshëm ashtu edhe për personelin me kontratë. Dosjet përmbajnë këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - CV e përditësuar; - Fotokopje ID; - Diploma dhe lista e notave e programit të ciklit të parë; - Diploma dhe lista e notave e programit Master; - Titujt akademik për ata pedagogë që kanë të tillë. <p>Evidenca 3.8 CV e stafit akademik të programit të studimit; Evidenca 4.7 Kontratat e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e</p>	<p>Stafi akademik dhe ai mbështetës në mësimdhënie bën të mundur përmbushjen e objektivave të programit të studimit Estetikë, të cilën e tregon edhe ngarkesa mësimore për çdo pedagog.</p> <p>Shembull i ngarkesës mësimore për dy anëtarë të stafit</p>

<p>detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>akademik me kohë të plotë për programin e studimit Estetikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - L.G: Lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Kozmetologjisë, e angazhuar në të tre programet e studimit “Hair Artist”, “Estetikë” dhe “Make Up”, ka një total prej 292 orësh në vit. - E.Z: Lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Kozmetologjisë, e angazhuar në të tre programet e studimit “Hair Artist”, “Estetikë” dhe “Make Up”, ka një total prej 280 orësh në vit. <p>Shembull i ngarkesës mësimore të një anëtari të stafit akademik me kohë të pjesshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - I. Ll: Angazhuar në semestrin e dytë për lëndë ndërdisiplinore / integrale (kategoria C), ka 50 orë. <p>Shembull: Lëndën bazë të kategorisë A “Historia e bukurisë” e zhvillon një pedagog i brendshëm, Rektori Prof. Dr. Q.M dhe një pedagog i jashtëm Dr. E.H.</p> <p>Përbushjen e objektivave të programit të studimit e bën të mundur edhe mjedisi mjaft i përshtatshëm dhe fleksibël për zhvillimin e lëndëve sipas specifikave të tyre, e konstatuar kjo në vizitën e GVJ në Institucion.</p> <p>Evidenca 1.10 Plani mësimor. Evidenca 1.11 Kuadri i përgjithshëm formues. Evidenca 1.12 Lista e personelit akademik të Kolegjit. Evidenca 4.2 Ngarkesa e detajuar 2019-2020. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL – plani mësimor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni mbështet dhe inkurajon kualifikimin profesional të personelit të programit të studimit kryesisht në lidhje me të rejat e fushës.</p> <p>Bashkëpunimi me Davines SPA, përdorimi i produkteve të tyre me brendin “Comfort Zone” dhe trajnimi i stafit mbi përdorimin e këtyre produkteve ose i leksioneve të hapura nëpërmjet skype-it edhe për studentët, është një pikë e fortë e këtij institucioni.</p> <p>Institucioni gjithashtu mbështet kërkimin shkencor të shefit të departamentit mbi impaktin e produkteve si të make up-it ashtu edhe të Estetikës në mjedis, duke bërë të mundur pjesëmarrjen dhe ndërgjegjësimin e studentëve të programit të studimit për ndihmesën e tyre në reduktimin e impaktit negativ të këtyre produkteve.</p> <p>Evidenca 3.8 CV e stafit akademik të programit të studimit;</p>

	Evidenca 4.1 Politikat dhe procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Në varësi të numrit të studentëve, institucioni ofron mjediset të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore si të asaj teorike ashtu edhe praktike. Hapësirat janë në përshtatje edhe me specifikat e secilës lëndë të programit të studimit. Mjediset mësimore të zhvillimit të lëndëve teorike janë të pajisura me pajisjet e nevojshme të teknologjisë të tilla si kompjuter dhe projektorë. Pjesë e pajisjeve mësimore janë edhe instrumentat e ndriçimit apo aparatet fotografikë për lëndën e fotografisë.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Klasat kanë elementet e nevojshëm të arredimit, ndiçimit optimal dhe shumë profesional. Mjediset mësimore janë të arregduara në mënyrë që të jenë të përshtatshme si për zhvillimin e leksioneve, seminareve apo ushtrimeve sipas specifikave të lëndës. Laboratori i praktikës profesionale për programin e studimit të Estetikës është i ndërtuar sipas specifikave të këtij programi dhe gjithashtu i pajisur me mjetet e punës dhe hapësirat e nevojshme për çdo student. Çdo student ka vendin dhe mjetet e tij të punës.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Çdo vend pune është i pajisur me mjetet e punës të programit të studimit të Estetikës, të cilat studenti mund ti përdorë në veprimtari të ndryshme dhe në praktika mësimore. Klasa është gjithashtu e pajisur me projektorë në rastin e demonstrimeve dhe me një ndriçim mjaft profesional.
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Gjithashtu studentët kanë hapësirat e tyre për të vendosur sendet personale.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për	

programet me karakter profesional.	Evidenca 3.6 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit. Evidenca 3.13 Raporti i ekspertit për infrastrukturën.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Kolegji TESS ka një bibliotekë dhe një arkivë digjitale të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe garanton shfrytëzimin në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë prej tyre. Pajisjet teknologjike mundësojnë edhe përdorimin e literaturës elektronike pa kufizime nga studentët në çdo kohë. Literatura bazë mësimore dhe ajo ndihmëse që përcaktohet në syllabuse është pjesë e bibliotekës së Kolegjit dhe arkivës. Studentët e shfrytëzojnë bibliotekën sipas një orari i cili nuk çënon orën mësimore dhe sipas rregullores së bibliotekës. Institucioni kujdeset për mirëmbajtjen dhe për rritjen e numrit të librave dhe materialeve mësimore duke pasuruar arkivën e saj. Duke pasur parasysh që Kolegji TESS është një institucion i ri i arsimit të lartë, është e nevojshme pasurimi i bibliotekës me libra dhe materiale ndihmëse bashkëkohore. Evidenca 3.7 Rregullorja e arkivës; Evidenca 4.3 Lista e literaturës.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe	Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, si me Universitetin e Arteve dhe me Universitetin e Mjekësisë. Në këto marrëveshje bashkëpunimi përfshihet si angazhimi i stafit të brendshëm për të bërë të mundur realizimin e programit mësimor e po ashtu bashkëpunimi në aktivitete

<p>profesional të studentëve.</p>	<p>me interes të përbashkët.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi janë lidhur edhe me institucione mbështetëse (kryesisht biznese) gjë e cila ka bërë të mundur që studentët e TESS të kryejnë praktikat profesionale, internshipet apo/dhe stazhe pranë këtyre institucioneve.</p> <p>Në këto veprimtari studentët kanë qenë të shoqëruar dhe të udhëzuar nga stafi përkatës akademik, që ka mundur përshtatjen e studentëve me natyrën e punës dhe për të bërë më efikas angazhimin në mënyrë profesionale të studentëve.</p> <p>Evidenca 1.7 Marrëveshje me institucione të tjera të arsimit të lartë; Evidenca 1.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mbështetëse; Evidenca 1.14 Institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Në rregulloren e tij të brendshme “Për organizimin dhe funksionin e kolegjit të lartë”, mbështetur në Ligjin e Arsimin e Lartë Nr 80/2015, Institucioni, ka ngritur strukturën administrative ku përfshihet Administratori si autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit.</p> <p>Pikërisht në këtë rregullore përcaktohen qartë edhe funksionet e administratorit, si:</p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të njëjësive bazë, sipas planit strategjik të zhvillimit të institucionit; - propozon kriteret e administrimit të burimeve financiare që ja paraqet Bordit të Administrimit dhe ndjek zbatimin e tyre; - zbaton vendimet e Bordit dhe Senatit akademik me karakter financiar dhe administrativ; - paraqet pranë këtij Bordi veprimtaritë financiare të institucionit në përfundim të vitit akademik; - plotëson kërkesat e rektoratit për përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare. <p>Në këtë mënyrë këto veprimtari janë në funksion të realizimit të programit të studimit dhe garantojnë qëndrueshmëri financiare dhe vijueshmëri të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të institucionit; Evidenca 1.3 Rregullore e institucionit.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni harton politika për regjistrimin e studentëve, i zbaton dhe i bën publike procedurat për pranimin e tyre.</p> <p>Në statutin e institucionit janë të përcaktuara kriteret e pranimit të studentëve.</p> <p>Bazuar në nenin 9 pranohen për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë TESS shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"> Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e Maturës Shtetërore, si dhe zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose diplomës përkatëse, që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi; Kryejnë pagesën e tarifës së caktuar vjetore sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës së studentit; Dorëzojnë dokumentat e nevojshme për lidhjen e kontratës.
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Në statutin e tij, Kolegji ofron një information të qartë mbi programet e studimit, ciklet e studimit, procedurat e pranimeve në këto programe studimi, mundësia për të ndjekur një program të dytë studimi, mënyrat e vlerësimit dhe diplomimi, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Institucioni publikon dhe vë në dispozicion të studentëve të interesuar kriteret e përgjithshme për pranimin dhe përzgjedhjen në programin e studimit, me karakter profesional “Hair Artist” dhe i udhëzon në lidhje me to.</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjithashtu institucioni vë në dispozicion të interesuarve zhvillimin e praktikave dhe veprimtarive profesionale institucionet bashkëpunuese dhe arrijet e studentëve edhe nëpërmjet faqes zyrtare WEB, Facebook, Instagram, etj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet</p>	

në funksion të realizimit të tij.				
Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Kolegji informon studentët nëpërmjet stafit të këshillimit të karrierës. Gjithashtu pjesëmarrja e Kolegjit me standën e tij në Panairin Work & Study synon informimin e hollësishëm mbi strukturën, organizimin dhe mbi mundësitë e punësimit që ofron programi Hair Artist studentëve të rinj.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion informacionin e përditësuar mbi zhvillimin e procesit mësimor, veprimtaritë e ndryshme praktike, lëndët formuese, momente nga procesi i mësimi, etj., nëpërmjet broshurave të ndryshme apo në kohës mediatike (televizioni, radio dhe mediat sociale, etj).</p> <p>Institucioni ka një staf menaxhimi i cili e bën informacionin të aksesueshëm dhe lehtësisht të arritshëm për studentët e interesuar.</p> <p>Guida Studentore, ka shërbyer për t'i informuar studentët mbi çështje të ndryshme dhe rrjetet sociale, për ta bërë të arritshëm informacionin nga studentët.</p> <p>Evidenca 1.1 Statusi i IAL; Evidenca 3.5 Aktivitete të organizuara nga Kolegji; Evidenca 4.4 Rregullore e pranimeve; Evidenca 4.5 Guida studentore Anglisht; Evidenca 4.5 Guida studentore Shqip; Evidenca 4.6 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB, e facebook, instagram, Youtube.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Kolegji disponon sistem të menaxhimit të cilin e realizon sekretaria mësimore e cila administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i	Për regjistrimin e studentëve, zyra e sekretarisë mësimore

<p>menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>mban një kopje të kontratës midis studentit dhe kolegjit si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për regjistrimin në programin e studimit. Zyra e sekretarisë bën plotësimin e regjistrimit me të dhënat e studentëve, gjithashtu edhe në regjistrin elektronik; kujdeset për ruajtjen e regjistrave; arkivon notat dhe provimet digjitale; ndjek procedurat e provimeve dhe të transferimeve; përgatit informacionet në bazë të kërkesave të organeve shtetërore administrative; arkivon dosjet e studentëve të diplomuar; mbledh dhe mban të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore përpilon dokumentacionin për marrjen e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me libreta pune dhe plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës. Dokumentacioni përmban të dhënat biografike, kualifikimet dhe aktivitetin mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore. Zyra e burimeve njerëzore bën koordinimin e punës për përmirësimin e strukturave akademike dhe administrative.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të informacionit dhe dokumenteve për të gjithë personelin dhe për studentët e programit të studimit. Këtë e realizon nëpërmjet emailit të personalizuar të shkollës; faqes zyrtare e WEB; Facebook; Instagram.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>Evidenca 1.7 Marrëveshje me institucione të tjera të arsimit të lartë; Evidenca 1.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mbështetëse; Evidenca 4.1 Politikat dhe procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore; Evidenca 4.6 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB, Facebook, Instagram. Evidenca 4.7 Kontratat e punës; Evidenca 5.2 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve; Evidenca 5.9 Rregullore e sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, www.tess.al dhe www.tess.edu.al, Kolegji TESS, jep informacion të nevojshëm mbi programet e studimit, mbi kriteret e</p>

faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	pramimit dhe të regjistrimit, mbi partnerët kryesorë, mbi llojin e diplomës, mundësitë e punësimit, personelin akademik, aktivitete të ndryshme, etj. Ky informacion vjen në formën e një guide studentore në gjuhën shqipe dhe atë anglisht. Evidenca 4.5 Guida Studentore anglisht; Guida Studentore shqip.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në rregulloren e institucionit përfshihen politikat për hartimin dhe zbatimin e procedurave dhe kriteret e pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore, dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e pranimeve është dokumenti bazë që përcakton kriteret e pranimit të studentëve në Kolegj. Politikat dhe procedurat për pranimin, ndjekjen dhe orientimin drejt tregut të punës garantojnë barazinë për të gjithë kandidatët për çdo student. Kriteret e pranimit për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë “Tirana Esthetics& Style School” për shtetasit shqiptarë ose të huaj:
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	a. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e Maturës Shtetërore, si edhe zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose diplomës përkatëse, që bën të mundur regjistrimin në

<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>b. Kryejnë pagesën e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës së Studentit;</p> <p>c. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës;</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në statut përcaktohen kriteret e pranimit të studentëve, në Kolegjet Profesionale të Larta mesatarja nuk është kriter pranimi. Kriteret për pranimin në programet e studimit për secilin program studimi gjithashtu edhe për studentët e huaj dhe vlerësimi i studentëve gjatë programit, përcaktohen nga organet kolegjiale dhe zbatohen me rigorozitet.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Pranimit të Studentëve përfaqëson një strukturë që është totalisht në shërbim të studentëve për t'i këshilluar dhe orientuar ata në mënyrë që të zgjidhin me sukses të gjitha çështjet akademike për të cilat ata shqetësohen. Politikat e orientimit dhe këshillimit të studentëve është e përcaktuar qartë në këto dokumenta: Politikat e mentorimit; Guida studentore.</p> <p>Qëllimi kryesor i tyre është lehtësimi i eksperiencës së studentëve në Kolegj dhe maksimizimi i përfitimeve nga kjo eksperiencë. Materiale të shumta dhe broshura informuese vihen në dispozicion të studentëve.</p> <p>Evidenca 1.3 Rregullore e institucionit; Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit; Evidenca 1.5 Rregullore e programit të studimit; Evidenca 3.10 Rregullore e provimeve; Evidenca 3.12 Rregullore e Diplomimit; Evidenca 4.4 Rregullore e pranimeve; Evidenca 4.5 Guida studentore; Evidenca 5.1 Këshillimi dhe mentorimi i studentëve; Evidenca 5.2 Modeli i kontratës së shërbimit me studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Institucioni, me fillimin e vitit të ri shkollor, organizon Javën e Parë Orientuese, për të informuar në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Ky informacion lidhet me të drejtat dhe detyrimet estudentëve, shërbimet e ofruara nga Kolegji, numrin e krediteve të nevojshme për të kaluar në vitin pasardhës, si edhe informacione të tjera të dobishme.</p> <p>Po ashtu institucioni, informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>TESS i orienton studentët për programet ekzistuese dhe për procedurën e ndryshimit të programit të studimit (kalimin nga një program studimi në tjetrin). Kjo realizohet përmes procesit të këshillimit akademik duke u vënë studentëve në dispozicion dokumentet e nevojshme.</p>			
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor duke bërë publike oraret zyrtare të zhvillimit të mësimit, oraret e shfrytëzimit të mjediseve të shkollës për punë individuale mësimore apo edhe orareve, logjistikës dhe hapësirave të zhvillimit praktikës mësimore në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë nevojave të studentëve. Në zbatim të kërkesave ligjore dhe të kontratës individuale me studentin, studenti është i siguar me siguracionin përkatës.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm përcakton për çdo anëtar të departamentit, një numër të caktuar studentësh për këshillim, gjatë të gjithë kohës së programit të studimit.</p> <p>Informacioni mbi programin e studimit i përditësuar mundësohet nëpërmjet faqes zyrtare e WEB, Facebook, Instagram, por më i detajuar mundësohet nëpërmjet emailit të personalizuar të institucionit.</p> <p>Evidenca 5.1 Këshillimi dhe mentorimi i studentëve; Evidenca 5.3 Programi i transparencës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Institucioni disponon statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitin e parë të programit të studimit. Sekretaria e Kolegjit është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave.
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, numrin e studentëve që përfunduan me sukses deri në diplomim programin e studimit dhe të studentëve që nuk janë diplomuar akoma. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, këtë e bën nëpërmjet të dhënave në regjistër, testesteve dhe vlerësimeve të ndryshme të pedagogëve përfshirë punësimin eventuale të tyre. TESS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani vendase dhe të huaja për t'i ndihmuar studentët të kryejnë internshipe dhe të punësohen. TESS ofron ndihmë të vazhdueshme për t'i integruar studentët në tregun e punës.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	Sa i përket mbledhjes së statistikave në Kolegji, person përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave, si dhe për komunikimin me organet kompetente shtetërore që administrojnë këto të dhëna statistikore, është sekretaria mësimore.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar në këtë program studimi 15 studentë, ndërsa në vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar 11 studentë, prej të cilëve 4 të pajisur me numër matrikullimi.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në dojet e studentëve përfshihen: - Formulari i të dhënave personale; - Diploma e shkollës së mesme e noterizuar; - Kartë identiteti; - Deklarata e aplikimit.

	<p>NJSBC është përgjegjëse për hartimin e raporteve analitike lidhur me cilësinë e studentëve në Kolegj. Kolegji shfrytëzon rrjetin e tij të kontakteve për të rekomanduar studentët e diplomuar për punësim. Ai mban të dhëna për punësimin në mënyrë të vazhdueshme për të mbikëqyrur mbarëvajtjen.</p> <p>Evidenca 5.6 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve;</p> <p>Evidenca 5.7 Punësimi i studentëve;</p> <p>Evidenca 5.8 Raporti analitik i përfitimeve nga praktikat mësimore;</p> <p>Evidenca 5.9 Rregullore e sekretarisë mësimore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni parashikon në statusin e tij, përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Në TESS studentët janë pjesë e niveleve të vendimmarrjes si, Senati Akademik, Këshilli i Etikës, etj. Gjithashtu TESS u jep të drejtën e organizimit përmes Këshillit Studentor dhe propozimit të përfaqësuesve të tyre.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në këtë kolegji studentët përfaqësohen në strukturat drejtuese të Kolegjit. Ata organizojnë Këshillin e studentëve dhe zgjedhin përfaqësuesit e tyre në organet e tjera të Kolegjit. Këshilli studentor është organi më i lartë drejtues i qeverisjes studentore dhe përfaqëson të gjithë studentët të cilët i kanë përzgjedhur ata dhe interesat e tyre. Në Këshillin Studentor programi i studimit Estetikë ka 1 anëtar. Gjithashtu TESS u vë në dispozicion ambjentet studentëve për organizimet e tyre. Kolegji ka mbështetur financiarisht studentët në realizimin e Diplomës.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të	Institucioni bën përpjekjet e nevojshme për hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Kolegji mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve, e cila

reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	pasqyrohet në orët mësimore të çdo lënde dhe të praktikës. Kolegji krijon mundësi joburokratike për përparimin e studentëve nëpërmjet eksperiencave të shumëllojshme të veprimtarive dhe praktikës mësimore.			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Kolegji TESS, nëpërmjet strukturave të posaçme, garanton përfshirjen e studentëve për hartimin, miratimin, monitorimin dhe rishikimin e programit të studimit Estetikë. Gjithashtu studentëve u mundësohet të japin mendimin edhe mbi barazinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke informuar nivelin drejtues të Kolegjit, për situatën aktuale dhe problematikat.</p> <p>Ky informacion i shërben drejtuesve të Kolegjit për të siguruar rritjen e cilësisë. Ky monitorim realizohet përmes pyetësorëve që u drejtohen studentëve dhe raporti iu bëhet me dije edhe stafit akademik e drejtues të Kolegjit.</p> <p>Evidenca 3.3 Pyetësi i studentëve; Evidenca 3.9 Procedurat e hartimit dhe miratimit të programit të studimit; Evidenca 5.4 Përbërja e Senatit Akademik; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Këshillit Studentor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School” (TESS) ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Kolegji (TESS) nëpërmjet programit të mentorimit dhe këshillimit të karrierës, realizon mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, duke pasur si</p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin</p>	<p>Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School” (TESS) ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Kolegji (TESS) nëpërmjet programit të mentorimit dhe këshillimit të karrierës, realizon mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, duke pasur si</p>

e studimit.	<p>prioritet nxjerrjen e studentëve të mirëkualifikuar në tregun e punës.</p> <p>Sipas statutit të Kolegjit, e konfirmuar edhe nga vizita në institucion, çdo student ka të drejtën për të patur një këshilltar akademik. Këshilltari është pjesë e personelit akademik. Këshillimi bëhet në mënyrë të vazhduar dhe periodike dhe përfshin: orientimin mbi procesin mësimor dhe vështirësitë që hasen në lëndë të ndryshme; përfshirjen e studentëve në vendimmarrje; orientimin për praktikën profesionale; orientimin në tregun e punës;</p> <p>Nëpërmjet programit të mentorimit dhe këshillimit të karrierës, institucioni mbledh të dhëna mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit Estetikë.</p> <p>Sa i përket ndjekjes së studentëve pas diplomimit, në këtë program studimi ende nuk ka student të diplomuar, pasi ky është viti i dytë i tyre.</p> <p>Një pjesë të studentëve të diplomuar (në këtë rast studentë të diplomuar në programin e studimit Make Up), Kolegji i ka angazhuar në projekte. Në vijimësi, institucioni bën përpjekje për cilësinë e punësimit të studentëve dhe pjesëmarrjen e tyre në projekte të ndryshme edhe nëpërmjet lidhjeve dhe kontakteve me institucione të ndryshme mbështetëse.</p> <p>Evidenca 5.1 Këshillimi dhe mentorimi i studentëve; Evidenca 5.6 Të dhëna për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve; Evidenca 5.7 Punësimi i studentëve.</p>			
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Estetikë” të Kolegjit Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Nëpërmjet programit të studimit “Estetikë”, Kolegji i lartë TESS, përgatit profesionistë me aftësitë e duhura si teorike ashtu edhe praktike për të adresuar çështje konkrete në fushën e Estetikës. Duhet të theksojmë këtu që, një pjesë e mirë e punonjësve në këtë treg pune janë të trajnuar nëpër kurse të ofruara nga njësi të ndryshme shërbimi të cilat nuk janë të licensuara për mësimdhënie.
2. Programi “Estetikë” është ndërtuar në bashkëpunim me profesionistë të fushës. Struktura dhe organizimi i programit të studimit, gjatë vitit akademik është fleksibël, e cila shprehet edhe në ndarjen e orëve teorike dhe praktike në lëndët profesionale, gjë që mundëson formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.
3. Syllabuset e lëndëve/moduleve pëmbajnë njohuritë e duhura për formimin profesional të studentëve. Në planin mësimor është synuar të ruhet një raport i drejtë midis formimit të përgjithshëm, formimit bazë dhe atij profesional të studentëve për të gjitha nivelet.
4. Anëtarët e personelit akademik, si të brendshëm ashtu edhe të ftuar, kanë kualifikimin e duhur dhe në përshtatje me lëndët përkatëse.
5. Në varësi të numrit të studentëve, institucioni ofron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike dhe praktike. Hapësirat janë në përshtatje edhe me specifikat e secilës lëndë të programit të studimit.
6. Ngritja dhe pajisja e laboratorit të Estetikës sipas specifikave të këtij programi studimi dhe me të gjitha mjetet e punës dhe hapësirat e nevojshme për çdo student.
7. Pasurimi i bibliotekës me literaturë në këtë fushë dhe angazhimi i stafit të TESS në hartimin e një teksti në gjuhën shqipe për këtë program studimi, gjë e cila ndihmon në arritjen e standardeve sa më të larta akademike e praktike në zhvillimin e programit.
8. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet mbështetëse (kryesisht biznese), ka bërë të mundur që studentët e TESS të kryejnë praktikat profesionale, internshipet apo/dhe stazhe pranë këtyre institucioneve. Kjo gjë mundëson përshtatjen e studentëve me natyrën e punës dhe e bën më efikas angazhimin e tyre në mënyrë profesionale.
9. Edukimi profesional është prioritet i Qeverisë Shqiptare, gjë që tregon rëndësinë e këtij programi studimi në mundësinë e integritit të shpejtë në tregun e punës të të diplomuarve nga ky program studimi.

Pika për përmirësim:

1. Programi i studimit “Estetikë” duhet të gjejë simotrat respektive në botë për të mundësuar mobilitetin e studentëve dhe të stafit akademik.
2. Duke qenë se ky program studimi është i pari në llojin e vet, në ofertën akademike në vend, evidentohet një mungesë literature dhe materialesh të tjera mësimore të përshtatshme për nivelin e edukimit profesional. Në këtë aspekt po punohet nga stafi



dhe partnerët e tjerë për të plotësuar këtë vakum. Literatura është në proces konsolidimi me qëllim botime cilësore në gjuhën shqipe.

Rekomandime:

1. Rekomandojmë që syllabuset e lëndëve, të rifreskohen me literaturë që pasqyrojnë të reja e fundit në fushën e Estetikës, kjo si rezultat qoftë i rinovimit të materialeve dhe mjeteve të reja por edhe si rezultat i zhvillimeve të teknikave të reja në këtë fushë.
2. Është i nevojshëm pasurimi i bibliotekës dhe i arkivës me libra dhe materiale ndihmëse bashkëkohore, në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
3. Konsolidimi i vazhdueshëm i literaturës dhe i botimeve cilësore në shërbim të lëndëve të programit të Estetikës.

Conclusions of evaluation of the “Aesthetic” study program of the Higher Professional College “Tirana Aesthetics & Style School”

Strengths and affirmations:

1. Through the “Aesthetics” study program, TESS College prepares professionals with the necessary skills, both theoretical and practical, to address concrete issues in the field of Aesthetics. Should be noted here that a large number of employees in this labor market are trained in courses offered by various service units which are not licensed for teaching.
2. The “Aesthetics” program is built in collaboration with professionals in the field. The structure and organization of the study program, during the academic year is flexible, which is expressed in the division of theoretical and practical classes in professional subjects, which enables the formation of students throughout the program and in accordance with employment.
3. The syllabuses of the subjects/modules contain the necessary knowledge for the professional formation of the students. In the curriculum, it is intended to maintain a fair relationship between the general, basic and professional formation of students at all levels.
4. The members of the academic staff, both internal and invited, have the appropriate qualification and in accordance with the respective subjects.
5. Depending on the number of students, the institution offers suitable environments for the development of theoretical and practical teaching activity. The spaces are also adapted to the specifics of each subject of the study program.
6. Establishment and equipping of the Aesthetics laboratory according to the specifics of this study program and with all the working tools and necessary spaces for each student.
7. Enrichment of the library with literature in this field and the engagement of TESS staff into designing a textbook in the Albanian language for this study program, which



helps to achieve the highest possible academic and practical standards in the development of the program.

8. Cooperation agreements with support institutions (mainly businesses), has made it possible for TESS students to perform professional practices, internships at these institutions. This enables students to adapt to the nature of the work and makes their professional engagement more efficient.
9. Professional education is a priority of the Albanian Government, which shows the importance of this study program in the possibility of rapid integration in the labor market of graduates from this study program.

Points for improvement:

1. The “Aesthetics” study program should find its respective homologues in the world to enable the mobility of students and academic staff.
2. Since this study program is the first of its kind, in the academic offer in the country, there is a lack of literature and other teaching materials suitable for the level of professional education. In this regard, work is being done by staff and other partners to fill this vacuum. The literature is in the process of being consolidated with the aim of quality publications in the Albanian language.

Recommendations:

1. We recommend that the syllabuses of the subjects be refreshed with literature that reflects the latest news in the field of Aesthetics, this as a result of the renewal of new materials and tools but also as a result of the development of new techniques in this field.
2. It is necessary to enrich the library and the archive with contemporary books and auxiliary materials, in order to increase the quality of teaching and learning.
3. Continuous consolidation of literature and quality publications in the service of the subjects of the “Aesthetics” program.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Silvana Nini
2. Msc. Ened Kuka



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


